



Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë

P r e z e n c a n ë S h q i p ë r i

**Fjala e Ambasadorit Osmo Lipponen, Kryetar i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri,
në hapjen e
Konferencës Ndërkombëtare të Donatorëve për Çështjet e Aftësisë së Kufizuar**

**Hotel Sheraton, Tiranë, Shqipëri
16 shtator 2004**

Zonja dhe zotërinj,

Dhjetë muaj më parë, unë pata kënaqësinë të flisja për temën e ditës së sotme, kur u mbledhëm për të diskutuar draftin e parë të Strategjisë Kombëtare për Njerëzit me Aftësi të Kufizuara. Që nga ajo kohë, ne përshkuam së bashku një rrugë të gjatë me partnerët tanë nga institucionet shtetërore dhe shoqëria civile, dhe, me shumë punë e përkushtim, arritëm në këtë pikë ku jemi sot.

Çfarë e bën punën për çështjet e aftësisë së kufizuar kaq të veçantë?

Para së gjithash, aftësia e kufizuar është një çështje që na shqetëson të gjithëve dhe ajo duhet të jetë një betejë e përbashkët, jo vetëm për ata bashkëqytetarë me aftësi të kufizuara, por për të gjithë ne për t'i kapërcyer barrierat, si në kuptimin fizik, ashtu edhe atë mendor. Këtë qëndrim duhet ta mbajmë gjithmonë dhe të mos e harrojmë atë pas 2003-shit, Vitit Evropian për Njerëzit me Aftësi të Kufizuara.

Së dyti, puna për Strategjinë Kombëtare kombinoi në një mënyrë shumë të përparuar të gjitha përpjekjet e shtetit shqiptar dhe shoqërisë civile. Kjo ishte vendimtare për qëndrimin e përparuar që mban tani Shqipëria duke e ndryshuar përkufizimin e aftësisë së kufizuar në termin ndërkombëtarisht të njohur të Organizatës Botërore të Shëndetësisë.

Së treti, përpjekjet e bashkuara të faktorëve shqiptarë tërhoqën bashkësinë ndërkombëtare drejt mbështetjes së këtij procesi. Ky është momenti për të falenderuar Z. Haack, komisioneri gjerman për çështjet e aftësisë së kufizuar, si dhe zyrën e tij për mbështetjen që ai dha në hartimin e strategjisë.

Ky është, gjithashtu, momenti për të falenderuar përfaqësuesit e donatorëve për praninë dhe interesimin tuaj në këto projekte, të cilat mbështeten në përparësitë e Strategjisë

Kombëtare. Përsëri falë një përpjekjeje të përbashkët, projektet u krijuan që të plotësonin njëri-tjetrin dhe, duke u zbatuar, të mundësonin një mjedis pa barriera për njerëzit me aftësi të kufizuara. Ky ndryshim mjedisi do të çojë, në fund të fundit, drejt pjesëmarrjes së plotë në të gjitha sferat e jetës publike.

Prezenca e OSBE-së zotohet të vazhdojë të mbështesë Qeverinë e Shqipërisë në përpjekjet e saj për të siguruar shërbime sociale cilësore dhe të qëndrueshme. OSBE-ja beson në një përcaktim që përfshin të gjithë shoqërinë, që do të thotë një shoqëri civile aktive me përfshirjen e të gjitha grupeve qytetare.

Ne jemi shumë të kënaqur me bashkëpunimin që patëm si me Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale, ashtu edhe me Fondacionin Shqiptar për të Drejtat e Njerëzve me Aftësi të Kufizuara, dhe shpresojmë që ta vazhdojmë atë derisa të arrijmë qëllimin tonë të përfshirjes, pjesëmarrjes dhe mundësive të barabarta për njerëzit me aftësi të kufizuara. Duke arritur këtë qëllim, ne, gjithashtu, hedhim një hap të rëndësishëm drejt një shoqërie civile aktive, e cila është garantuesja e një zhvillimi të lirë dhe demokratik.

U uroj të gjithëve në një shkëmbim të frytshëm informacionesh dhe diskutimesh, dhe le të shpresojmë që donatorët e pranishëm të shfaqin interes për ndonjërin prej projekteve.

Ju faleminderit!